

**-AKT THEMELIMI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"Medical Products Albania (MP ALBANIA) " SH.P.K.**

Sot, ne Tirane, me **daten 05.07.2017**, me cilesine e ortakeve themelues te shoqerise:

- **Z. EMIL XHUVANI**, i dt 31.05.1964, lindur dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Letrnjoftimin me Nr. 028392616 dhe NR. Personal G40531082W

kane vendosur themelimin e shoqerise tregtare **"Medical Products Albania (MP ALBANIA) " SH.P.K.**

Me nenshkrimin e ketij Akti Themelimi te nje shoqerie tregtare, nenshkruesit dhe themeluesit e saj marrin persiper te realizojne e te respektojne te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga klauzolat e meposhtme, te cilat do te specifikohen gjeresisht ne Statutin e shoqerise:

**THEMELIMI I SHOQERISE**

Ne mbeshetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar **"Medical Products Albania (MP ALBANIA) " SH.P.K.**

(me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria") nga Ortaket themelues te saj.

**FORMA E SHOQERISE**



Shoqeria **"Medical Products Albania (MP ALBANIA) " SH.P.K.**  
. me poshte e referuar si "Shoqeria",. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar krijuar ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite Tregtare", dhe rregullohet prej ketij ligji, dhe statutit te shoqerise si dhe prej cdo dispozite tjeter ligjore te aplikueshme.

## **II EMRI I SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA**

### **Neni 1**

#### **Emri**

Emri i shoqerise eshte **"Medical Products Albania (MP ALBANIA) "**  
**SH.P.K.**

Ne cdo dokument, fature, reklame dhe publikime emri i shoqerise do te pasohet nga:

- (i) fjala "me pergjegjesi te kufizuar" apo "sh.p.k"
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

### **Neni 2**

#### **Selia**

Selia administrative e shoqerise do te jete ne **Rrugen " Budi " Pallati Classic ap1/1 Tirane.**

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar, duke filluar prej momentit te regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

## **III OBJEKTI I SHOQERISE**

#### **Neni 4**

#### **Objekti**

Objekt i veprimtarise do te jete:

Import - Eksport pajisjesh mjeksore, pajisjesh laboratorike, aparate mjeksore, medikamente, aksesore mjeksore etj. Shitje me shumice dhe pakice.

### **IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 LEKE (njqindmije) leke.

Kontributet e ortakeve te shoqerise ne kapitalin themeltar jane si me poshte vijon :

**Z. EMIL XHUVANI ZOTERON 100 % TE KAPITALIT FILLESTAR TE SHOQERISE ME VLERE 100000LEKE(NJEQIND MIJE LEKE)**

#### **Neni 6**

#### **Organizimi**

Shoqeria do te drejtohet nga nje Administrator. Kete detyre do ta kryej per periudhen e pare prej 5 vjetesh, **Z. EMIL XHUVANI**, i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblese se Pergjitheshme.

### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**EMIL XHUVANI**

*Emil Xhuvani*  
*Xhuvani*